



REPUBLIKA E SHQIPERISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1875/₄ Prot.

Tiranë, më 10/7/2012

Lënda: Rekomandim për kontrolluesin “Spitali Rajonal Vlorë”.

REKOMANDIM

Nr. 19 / datë 10/7 /2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit “Spitali Rajonal Vlorë”.

KONSTATOVA

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka zhvilluar kontroll administrativ pranë kontrolluesit “Spitali Rajonal Vlorë” me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Spitali Rajonal Vlorë, për kategorinë e subjekteve të të dhënave “pacient”.
- Siguria e të dhënave personale, masat e marra nga kontrolluesi Spitali Rajonal Vlorë për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 21).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin mbi shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit administrativ, pretendimet e kontrolluesit mbi këto shkelje si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi “Spitali Rajonal Vlorë” kartelat klinike te pacienteve te cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive si dhe informacion konfidenciale lidhur me shëndetin e pacientit (analiza, diagnoza etj.), i mban në zyrat e tij (infirmieri/k/infirmieri) mbi tavolinë, dritare etj., dhe jo në dollapë apo kasaforta të siguruara me çelës.
2. Kontrolluesi “Spitali Rajonal Vlore”, mbledh dhe përpunon të dhëna nëpërmjet një aplikacioni në programin “ACCES” (aplikacion për menaxhimin e të dhënave me

emërtim "CISP" të ndërtuar në programin "Microsoft ACCES" që prej vitit 2002, ku ruhen të dhënat personale dhe gjithë informacionin që përmbajnë kartelat e pacientëve) dhe nuk ka marrë masa në lidhje me kufizimin e aksesit në këtë aplikacion, si dhe nuk ka marrë masat e përshtatshme për ruajtjen e programit dhe të dhënave të këtij aplikacioni (Backup të sistemit dhe të dhënave të tij).

3. Në kontratën e lidhur me ofruesin e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, nuk ka të përcaktuar klauzola standarte për konfidencialitetin.
4. Konstatohet se kontrolluesi "Spitali Rajonal Vlore", nuk ka hartuar rregulla për qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të sistemit CCTV, të cilin aktualisht e ka në proces instalimi.
5. Kontrolluesi "Spitali Rajonal Vlore", nuk ka bërë njoftimin pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale që ai kryen në ushtrimin e aktivitetit të tij.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale konstatimet e mësipërme gjatë ushtrimit të kontrollit administrativ i i konsideron shkelje të neni 27 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Masat për sigurinë e të dhënave personale" (Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi).

Udhëzimin nr. 3 dhe 13 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme", nenit 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj si dhe nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

Për sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të Kodit të Procedurave Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa për sigurinë fizike të kartelave klinike të pacientëve, (të cilat mbartin të dhëna personale dhe sensitive si dhe informacion konfidencial lidhur me shëndetin e pacientit, analiza, diagnoza etj.), duke u vendosur në dollapë apo kasaforta dhe zyra të siguruara me çelës.

2. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të marrë masa teknike dhe organizative:
 - Për kufizimin e aksesit në kompjuterët dhe aplikacionin "CISP" duke vendosur fjalëkalimet e punonjësve të autorizuar për të patur akses,
 - Të marrë masa teknike dhe organizative duke i shoqëruar specialistët e jashtëm gjatë kohës që janë duke shërbyer për programet (sistemet software) apo pajisjet fizike të kompjuterit (sistemet hardware),
 - Të shmangë nxjerrjen kompjuterëve jashtë ambienteve të kontrolluesit
 - Të dokumentojë shërbimet apo ndërhyrjet në pajisjet kompjuterike.
3. Të marrë masat e përshtatshme për ruajtjen e programit dhe të dhënave të këtij aplikacioni (Backup të sistemit dhe të dhënave të tij).
4. Në zbatim të neni 28 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të merren masa që në kontratat e lidhura me ofruesit e shërbimit për pajisjet dhe sistemet kompjuterike, të vendosen, parashikohen klauzola standarte për konfidencialitetin.
5. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Udhëzimin nr. 3 dhe 13 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme" të hartojë rregullore për qëllimin dhe mënyrën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit CCTV.
6. Në zbatim të nenit 21 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda një afati prej 10 ditë, të plotësojë detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale që kryen në ushtrimin e aktivitetit të tij.
7. Kryerja e detyrave të tjera të lëna në këtë Rekomandim, të realizohet brenda një afati kohor prej dy muaj.
8. Në rast mospërbushje të këtij Rekomandimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 " Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit *"Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave"*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

